

**Kontributet në luftën
për qytete
të qëndrueshme**



Maj 2017

Kontributet në luftën për qytete të qëndrueshme

Projekti Act4City

Maj, 2017

HYRJA- organizata kulturore të pavarura dhe qytete të qëndrueshme në Ballkan

Me mbështetje të Fondit Ballkanik për Art dhe Kulturë (BAC), katër organizata të shoqërisë civile të rajonit – Expedition nga Kotori, Ministria e Hapësirës nga Beogradi, City Creative Network – Shkup dhe Art punëtorja Lazareti nga Dubrovniku – e realizuan projektin Act4City. Projekti kishte për qëllim të promovojë menaxhimin e qëndrueshëm me qytetet dhe nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta arsimore, artistike dhe angazhuese t'i nxisë organizatat kulturore të pavarura të rajonit në mënyrë që të njëjtat të kontribuojnë në angazhimin për qytete të qëndrueshme.

Në suazat e projektit, u organizuan fokus grupe me përfaqësues dhe përfaqësuese të skenës së pavarur të këtyre katër vendeve, pastaj tryeza të rrumbullakëta me palë të ndryshme të interesuara dhe përfundimisht konferencë e cila në një vend mblodhi numër më të madh të iniciativave qytetare të cilat synojnë të kontribuojnë për zhvillim më demokratik, më të gjelbër, më përgjegjës të qyteteve të tyre. Këqyrja në këto takime krijoi bazë informative edhe për këtë tekst.

Përveç kësaj, secili nga partnerët realizoi një intervenim urban në qytetin e vet. Në Dubrovnik, artistët e hulumtuan hapësirën në pjesën e lënë pas dore të qytetit (Pustijerna), qëndruan atje së bashku me qytetarët dhe qytetaret i analizuan planet e qytetit për rregullimin e kësaj hapësire dhe më gjerë për fatin e qytetit. Në Shkup studentët e arkitekturës krijuan diskontinuitet në projektimin e qytetit dhe krijuan skenë teatrore të përkohshme në bregun e lumit si hapësirë për takime, hulumtime, evenimente të përbashkëta dhe hulumtime. Në Beograd filluan të mbijnë instalime, ekspozita në qytet dhe tabela shkollore, si hapësira të rralla dhe të nevojshme për kritikë, mos pajtim dhe planifikime për disa politika më ndryshe për zhvillim urban nga ato të cilat po realizohen për momentin në qytet. Në Kotor, qytetarët dhe qytetaret thurnin tregime për qytetin dhe u bënë thirrje bashkëqytetarëve për një shfaqje gjithë natës ku do të shtronin pyetje të shumta për qytetin dhe për artikullimin e tij, i cili çdo herë i gatshëm i pret turistët, nuk ka vend as mundësi - për korrupsion të policisë komunale, nëpërmjet ndërtimeve joligjore deri te hyrja më shumë se problematike e kruzerëve në gadishull.

Praktika e këtillë nuk është e zakonshme në projektet të cilat synojnë të merren me zhvillim të qëndrueshëm. Ekskursione në natyrë, riciklim, rregullim i sipërfaqeve të gjelbra, mbjellja e drurëve, paraqitja e pjesëve të shëmtuara të qytetit, largimi i mbeturinave... Aksione të cilat të shëmtuarën e shndërrojnë në të bukur, të cilat vendosin rend në mes të kaosit, të cilat i zgjidhin problemet, kjo është qasja e zakonshme. Së këndejmi, është lehtë të imagjinohen një sërë pyetje cinike, në drejtim të aktiviteteve të këtij projekti. Në ç' mënyre tribunat dhe ekspozitat e pikturave do të na e shpëtojnë planetin? Në vend se të luftojnë me ndotësit e mëdhenj dhe me ato qese të shëmtuara najloni, ata bëjnë shfaqje teatrore për atë se si nuk mund të flenë nga zhurma e cila vjen nga kafenetë! Nuk na duhen më shumë probleme, as vazhdimisht të na përkujtoni për ato!, do të revoltohet dikush.

Teksti i cili gjendet para ju, ndërkaq i cili ndjek dhe vendos dialogun me aktivitetet e tjera të projektit, është përpjekje të ofrojë përgjigje në lidhje me pyetjen e cila është ngushtë e lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm me ruajtjen e mjedisit jetësor ose me

shpikjet teknologjike në fushën e energjetikës, komunikacionit ose prodhimin që është problematike për çka na nevojitet objektiv me gamë shumë të gjerë që të kuptojmë dhe transferojmë politikat aktuale dhe drejtimet e zhvillimit. Teksti njëkohësisht është edhe përgjigje e pyetjes, çfarë rëndësie kanë organizatat kulturore dhe artistike dhe kolektive në luftën për shoqërinë e cila është më e qëndrueshme dhe më e drejtë.

Pas sqarimeve të shkurta metodologjike dhe terminologjike në pjesën e ardhshme, teksti kalon në historinë e ideve të cilat rezultuan me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe më shumë herë shtruan disa pyetje të pa lakmueshme për vetë agjendën për "zhvillim të qëndrueshëm". Pastaj, teksti i përpunon narracionin dhe formularët e mendimeve të cilat i përcjellin shume biseda për zhvillim të qëndrueshëm, që përfundimisht, në pjesën e fundit, teksti ofron rekomandime për aktorët e ndryshëm të cilët në praktikë angazhohen për zhvillim të qëndrueshëm.

Zhvillim i qëndrueshëm - teknologjia përballë politikës

Projektet, programet dhe fondet që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, studimet dhe librat mbi temën e zhvillimit të qëndrueshëm, komunitetet e qëndrueshme, arkitekturë e qëndrueshme, qytete të qëndrueshme - tregimet për qëndrueshmërinë janë kudo rreth nesh. Në një botë që gjoja ndryshon më shpejt se kurrë - sigurisht është interesante se një ndjenjë e tillë ekziston tashmë të paktën dy shekuj - Qëndrueshmëria dhe ruajtja veprojnë si zgjidhje shpëtimtare që na pengojë të biem në humnerën e pretenduar të së nesërme. Qëndrueshmëria në imaginariumin publik vendoset përballë rënies, zhdukjes, humbjes dhe shkatërrimit të plotë të llojit apokaliptik. Të thuash se diçka është e paqëndrueshme, u bë si fyerje siç do të thotë të jesh i qëndrueshëm është një tregues i qartë i urtësisë, i përparimit dhe mprehtësisë. Individët, grupet, organizatat, institucionet, qeveritë madje edhe shtete dhe kultura të tëra janë të pozicionuar në shkallën e qëndrueshmërisë që sjell ton të fortë moralizues. Ata që diskutojnë, që mbështesin dhe financojnë qëndrueshmërinë si temë zakonisht perceptohen si të përgjegjshëm, të drejtuar kah së ardhmes, të vetëdijshëm dhe sigurisht të qëndrueshëm - gara ndaj qëndrueshmërisë është e hapur.

Njëkohësisht, vetë ideja e qëndrueshmërisë është shumë fluide, kontradiktore dhe jo konsekuente. Qëndrueshmëria e njërit do të thotë ndryshimi dhe zhdukja e një tjetri. Në qoftë se duam të ruajmë mjedisin tonë natyror, duhet ta ndryshojmë kulturën (të themi kulturën për drejtimin e veturës). Nëse duam që brezat e ardhshëm të mund t'i gëzojnë resurset në dispozicion, të tanishmit duhet të ndalojë së u gëzuar në të njëjtat në mënyrë që në shikim të parë ju shkon për shtati. Kur përfshijmë historinë, punët bëhen edhe më problematike. Pse për qëndrueshmërinë nuk diskutonim në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kur Perëndimi zhvillohej me paqëndrueshmëri (edhe pse edhe atëherë ekzistonin shqetësimet), por flasim tani kur Lindja zhvillohet në të njëjtën mënyrë? Pra, qëndrueshmëria është term shumë i diskutueshëm e vështirë për tu përkufizuar. Dhe çdo ide që njëkohësisht është mjaft e paqartë dhe jashtëzakonisht e fuqishme është një armë e rrezikshme në arenën politike. Në këtë

kontekst të tensionuar pothuajse të përmasave epike të idesë së qëndrueshmërisë, çdo bisedë për qëndrueshmëri duhet të jetë subjekt dyshimi.

Prandaj, kur flasim për qëndrueshmërinë e qyteteve, krizave ekologjike dhe temave të tjera të ngjashme, ekzistojnë dy kënde të lidhura të analizës të cilat është e rëndësishme të dallohen nga fillimi. Një i referohet gjetjeve të ekologëve, biologëve, urbanistëve, kimistëve dhe qarqeve të tjera shkencore dhe aktivistëve për gjendjen në të cilën gjendet një mjedis. Çështje e rëndësishme të nivelit të caktuar janë: Në cilën mënyrë po ndryshon mjedisi tonë natyror ose i ndërtuar?; Si do të mund të duket drejtimi i mëtejshëm si një ndryshim?; Çfarë e shkakton atë dhe cilat janë mekanizmat e ndryshimit?; sidomos çfarë është ndikimi i komuniteteve të njerëzve në këto zhvillime dhe me këtë edhe përgjegjësitë e tyre? Së fundi, ky nivel i analizës ka të bëjë me hartimin e mënyrave të mundshme të ndikimit më të ndryshëm dhe më pozitiv në mjedis, ndikim në mjedis në aspektin e teknologjisë së prodhimit, ndërtimit, transportit dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor. Këndin e parë do të mund ta quajmë teknologjia në një zhvillim të qëndrueshëm (urban).

Për dallim të tij këndi tjetër i analizës merret me pasojat dhe shkaqet ekonomike, politike dhe kulturore nga ndodhitë e tilla në mjedisin material për të cilat dëshmon grupi i parë. Në këtë nivel, lloji i pyetjeve që bëhen janë: Çfarë lloj konfigurime ekonomike, politike dhe të tjera kanë mundësuar për të ardhur në këtë situatë? Si kanë ndryshuar kuptimet e "natyrës", "njeriut", "qytetit"? Si ndikojnë ndryshimet në mjedisin material në ndryshimin në idetë për qytetin, drejtësinë, pushtetin? Si është e mundur për të fillohet procesi i ndryshimit? Çfarë masa duhet të merren nga aktorë të ndryshëm për të reaguar ndaj ndryshimeve në mjedisin në mënyrë adekuate? Këndin e dytë mund ta quajmë një politikë të zhvillimit të qëndrueshëm.

Këto dy kënde të analizës janë të lidhura ngushtë. Sa mjete do të veçohen për ekspedita hulumtuese në Arktik, sa studentë do të mbështeten të studiojnë ekologjinë, sa investohet për hulumtim në publikime të hulumtimeve ekologjike dhe sa gjetje nga hulumtimet ekologjike do të pranohen, mbështeten dhe do të komunikohen publikisht në lidhje të drejtpërdrejtë me pritjen e këtyre hulumtimeve në shoqëri, gjegjësisht reagimi ndaj tyre. Kriza ekologjike ka filluar shumë kohë përpara politikës së ekologjisë. Oxhaqet e stabilimenteve industriale ndotin ajrin më shumë se dy shekuj, por studentët e universitetit nuk mund të merreshin me të në doktoraturat në shekullin e nëntëmbëdhjetë - ata që merreshin me ato (ose iknin prej tyre) ose ishin të çmendur, por jo anëtarë të çmuar të komunitetit shkencor. Në anën tjetër, ideja për natyrën dhe shoqërinë është formuar mijëvjeçarë përpara se dikush të vërente se njeriu ndikon keq mbi mjedisin natyror dhe se do të nevojitet një ndryshim jo vetëm në mjedisin natyror dhe teknologjinë e prodhimit që të vërehet kjo, por edhe në mënyrën e të menduarit rreth natyrës dhe shoqërisë. Prandaj, këto dy kënde të analizës janë të pandara. Megjithatë, shumica e botimeve për qytet të qëndrueshëm merren me çështjet me këndvështrim të drejtë të fushës. Pjesa tjetër anashkalohet për arsye mjaft të qartë. Çfarë mund të shihet nga këndvështrimi tjetër së pari është përgjegjësia etike nga pozita të ndryshme për të ardhur në gjendje të caktuar si dhe përgjegjësi për fillimin e ndryshimit.

Në këtë tekst, para së gjithash do të merremi me këndvështrimin e dytë. Pse është e rëndësishme kjo pikëpamje për aktorët e fushës së kulturës të pavarur që kërkojnë të iniciojnë ndryshime në qytetet e tyre? Ndryshe nga zgjidhjet teknike të ekspertëve në fushën e transportit, ekonomisë, inxhinierisë ose planifikimit urban, artit dhe kultura bartin një potencial të ndryshëm të kontributit për ndërtimin e qyteteve.

Megjithatë, kjo potencë në dekadat e fundit duket se nuk është aplikuar mjaftueshëm. Për më tepër, mënyra si merret kultura dhe arti me zhvillimin e qëndrueshëm në dekadat e fundit ka qenë shumë problematike. Një nga reagimet e para të aktorëve në idenë kulturore të zhvillimit të qëndrueshëm ishte frika nga boshllëqet në politikat publike. Në tri shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm (mjedisor, ekonomik dhe social) nuk e kishte kulturën. E gjithë vëmendja është përqendruar në atë që kultura dhe artit të jenë disi të 'mbërthyer' në themel dhe për vite është diskutuar ideja për "shtyllën e katërt" të zhvillimit të qëndrueshëm. Në vend të kritikave të këtyre politikave, të cilat siç do të shihni ishin shumë problematike, sektori kulturor e ofroi veten si mbështetje, nëse tregohej pak vëmendje. Pasi bllokimi i konceptit të suksesit të zhvillimit të qëndrueshëm kishte sukses, vijoi vala e projekteve në të cilat organizatat kulturore dhe artistike kontribuojnë në zbulimin e qyteteve dhe i zvogëlojnë tensionet aty ku ka përmbajtje estetike të pranueshme dhe argëtuese. Edhe një herë arti dhe kultura në përgjithësi vendoset në prehër të rrjedhës aktuale politike.

Megjithatë, siç u përmend në hyrje, arti dhe kultura kanë potencial për të kontribuar në mënyra të ndryshme frymëzuese, të reflektojnë jo vetëm për qytetet, por për jetën si të tillë. Këtë e tregojnë shumë segmente të artit ekologjik. Shumë muze, teatro dhe qendra kulturore krijojnë hapësirë për takime, ngushëllime dhe kritika. Sot, kjo qasje na është e nevojshme. Kjo është pika e fillimit dhe e mbarimit e këtij teksti.

Në faqet në vijim fillimisht do të merremi me historinë kritike të zhvillimit të qëndrueshëm dhe qytetit të qëndrueshëm, si do të tregonin disa mekanizma të transferimit dhe manipulimit me idetë dhe tregimet mbi zhvillimin e qëndrueshëm, në mënyrë për ta ruajtur *status quo*-në. Pastaj do të paraqesim disa rekomandime që minojnë projektet e transformimit. Më në fund do të ofrojmë një sërë rekomandimesh për aktorë të ndryshëm të cilët dëshirojnë të kontribuojnë në ndryshimet themelore në qytetet e tyre.

Histori e shkurtë e politikave për zhvillim të qëndrueshëm

"Pirmani tani përpiket të shuajë zjarrin të cilin e ndez dhe të shpallet shpëtimtar". ¹

Politikat për zhvillim të qëndrueshëm janë krijuar në vitet e tetëdhjeta, në moment specifik dhe vendimmarrës të kufijve ekonomik, ekologjik, shoqëror dhe politik të negociatave dhe luftërave të cilat kanë zgjatur disa dekada me radhe, por edhe shekuj. Megjithatë, diskursi "zhvillim i qëndrueshëm" u normalizua shumë shpejt.

¹Autor/e i/e panjohur i cituar në: Luković, S, Spašavaju S Kotor, ata që e kanë shkatërruar, Lajme. Gjetet në: <http://www.vijesti.me/vijesti/spasavaju-kotor-oni-koji-su-ga-unistavali-923166>

Sot ai tingëllon njëkohësisht edhe frustrues dhe ikonik – sikur ishte dashur të bënim mjaftueshëm nga aspekti civilizues që të mund ta kuptonin një gjë kaq të thjeshtë dhe të natyrshme. Sot është krejtësisht normale, të mendohet se zhvillimi duhet të jetë i qëndrueshëm, ndërsa edhe më normal është qëndrueshmëria dhe çfarë do lloj shpenzimi i kohës të nënkuptojë edhe zhvillim. Ngjashëm me këtë, triptiku i famshëm i zhvillimit të qëndrueshëm – rritje ekonomike, rruajtje e mjedisit jetësor dhe drejtësi sociale – veprojnë krejtësisht natyrshëm. Së këndejmi është e pazakonshme, në përgjithësi të mendohet për shkaktimin e zhvillimit të qëndrueshëm si nocion dhe si politikë.

Megjithatë, që t'i kuptojmë, ose edhe më tepër, që të jemi në gjendje të pranojmë dhe të refuzojmë rëndësinë, mesazhin, lidhjet dhe rekomandimet të cilat i ofrojnë, me fjalë të tjera si do ta kishim zbatuar në mënyrë kritike, nevojitet të kuptojmë si dhe pse është shkaktuar, çfarë ka zëvendësuar, çfarë ka sjellë me vete dhe çfarë ka larguar dhe cilat janë pasojat politike dhe shoqërore për pajtimin ose mos pajtimin me të. Në këtë pjesë do të propozojmë disa imazhe të rëndësishme të historisë, para së gjithash Mendime dhe histori të Perëndimit, të cilat janë të dobishme për procesin e dekonstruktimit të tij dhe detyrën e kuptimit. Këto imazhe do të përfshijnë disa momente kryesore në zhvillimin e politikave ekologjike, ekonomike dhe socio – kulturore të cilat në momentin e krijimit të politikave të zhvillimit të qëndrueshëm janë bashkuar. Duke pasur parasysh që zhvillimi i qëndrueshëm në imagjinatën popullore lidhet zakonisht për ekologjinë, ajo lidhje do të jetë pika jonë fillestare.

Lëvizja ekologjike, si luftë e vetëdijshme, e organizuar, luftë shoqërore - politike, ka filluar shumë para hipikëve ikonikë dhe aktivistëve grinpis.

Në fakt, këtë në masë të madhe e lidhim me lëvizjet ekologjike në gjysmën e dytë të shekullit njëzet, është krijuar një shekull më herët. Iniciativat për daljen në natyrë më larg qyteteve, komunave në pyje të cilat synojnë të jetojnë në “përputhje me natyrën”, artistët të cilët pikurojnë katastrofa ekologjike, shkencëtarë të cilët kalkulojnë dhe projektojnë fundin, apele dhe luftëra për ruajtjen e natyrës... Mirëpo, pozita e betejave ekologjike në raport me betejat, lëvizje dhe prioritetet e tjera ka ndryshuar. Që të kuptojmë si dhe pse është krijuar projekti i cili për herë të parë e ka problematizuar raportin e njeriut ndaj natyrës, fillimisht në pika më të shkurta do të bëjmë skicë të kontekstit të shekullit nëntëmbëdhjetë gjatë të cilit është formuar.

Së pari, idetë biblike dhe religjioni i krishterë, edhe pse të lëkundura nga shkenca gjithnjë e më e fuqishme dhe me projektet racionale dhe moderne, e formulon ende fuqishëm raportin dominues të njeriut perëndimor ndaj natyrës si ndaj subjektit të zotërimit njerëzor (që më vonë është bërë bazë për idenë e natyrës si resurs) dhe ndaj mosbesimtarëve si ndaj njerëzve të rangut më të ulët (që mund të arsyetojë lehtë krimet misionare dhe kolonizuese në emër të religjionit në mbarë botën). Së dyti, arsimit në mënyrë plotësuese e thellon hendekun ndërmjet njeriut si qenie racionale dhe natyrës dhe e kremton racionalitetin instrumental i cili orientohet kah progresit, prodhimit, eksplorimit të natyrës dhe menaxhimit. E treta, kapitalizmi e përjeton lulëzimin e tij pas fitores së borgjezisë në një sërë revolucionesh, i cili pas

konsolidimit të brendshëm dhe eksplodimit të zhvillimit industrial, është në kërkim të resurseve jashtë territorit të tij. Imperializmi dhe kolonializmi fitojnë një shtytje të re sipërmarrëse e cila i ndjek më larg dhe më thellë në çdo segment të planetit. Përfundimisht, nacionalizmi mundëson bashkimin e grupeve të ndryshme rreth miteve më mëdha nacionale dhe krijimin e shteteve të fuqishme moderne.

Në këtë kontekst, paraqiten një sërë protesta. Së pari, projektet romantike kulturore nga fundi i shekulli tetëmbëdhjetë dhe fillimi i shekullit nëntëmbëdhjetë, të cilat shënuan shumë hapësira evropiane, e vunë në pikëpyetje projektin arsimor dhe racionalitetin i cili gjendet në bazën e revolucionit industrial. Krijuesit romantikë, filozofë dhe mendimtarë, duke qenë në kërkim të mënyrave që bota të mendojë jashtë standardeve racionale, shkencore, arsimore e gjejnë natyrën si burim të bukurisë, moralit dhe mençurisë². Në kërkim të rrugëdaljes nga rrethi magjik i imperializmit, industrializimit dhe urbanizimit, ata në vende të largëta dhe në rrugë dytësore gjejnë "komunitete organike", mendime të mençme tradicionale, poezi art dhe mënyra të jetesës të cilat për ta janë më të sigjerta, jetë që ka kuptim dhe e plotësuar, në këtë mënyrë i shënojnë, interpretojnë, grumbullojnë dhe promovojnë.

Së dyti, shtresa e fshatarëve të varfër dhe punëtorë shpejt pas revolucionit në të cilin morën pjesë nuk morën pjesën e duhur të "barazisë, lirisë dhe vëllazërisë" dhe kërkuan pozitë më të mirë për vete. Komunizmi si lëvizja më e fuqishme e cila i përfaqëson interesat e shtresave të varfra të cilat u gjendën në cak të eksploatimit industrial tregon themelet e problemit dhe kontradiktat e kapitalizmit dhe paraqet armik të fuqishëm të elitës qeveritare pikërisht për shkak të asaj që në plan të parë të luftës së saj e vendosin jo barazinë ekonomike.

Së treti, teoria biologjike e evolucionit e vuri në pikëpyetje ndarjen paraprake të rrënjësor, të rreptë të natyrës dhe njeriut, e cila bazat e saj para së gjithash i ka në Bibël. Për dallim nga ideja se bimët dhe kafshët janë krijuar që t'i shërbejnë njeriut i cili është zotëruesi, teoria e evolucionit sugjeron se njerëzit janë pjesë e barabartë e zinxhirit të krijimit, dhe si të tillë janë pjesë e pa ndashme e natyrës. Siç shkruan një nga themeluesit e ekologjisë, Ernest Hekel (i cili njëkohësisht e ka krijuar edhe nocion ekologji): "njeriu nuk është mbi natyrën, por është në natyrë".³

Afërsia e njeriut me natyrën njëkohësisht do të thotë edhe se raporti ndaj natyrës si resurs kuptimi i së cilës është t'i shërbejë njeriut - është problematik, "i pa natyrshëm" dhe i gabuar.

Përfundimisht, në hapësirën politike dëgjohen edhe zërat e të tjerëve "të tjerët" të cilët gjithashtu nuk përputhen në imazhin e botës dhe njeriut të asaj kohe. Lëvizja feministe lufton që gratë të pranohen në hapësirën publike si qenie njerëzore të barabarta. Lëvizjet antiimperialiste luftojnë për lirinë e popujve dhe kulturave joevropiane, ndërsa kundër shkencës racore (Eugjenika), sundimit të robërve, padrejtësive në tregtinë ndërkombëtare dhe pushtetet kolonialiste.

²Për shebull Grim poezinë e famshme popullore e quan Naturpoesie. Shih më tepër në Peter Burke: Popular Culture in early Modern Europe. Harper Torchbooks, 1978.

Edhe pse ndërmjet këtyre lëvizjeve ekziston dallim i madh, ajo që i bashkon fillimisht janë armiqtë e përbashkët – kapitalizmi, patriarkati, industrializimi. Nga ana tjetër, të përbashkëta janë inspirimi dhe vizioni për të cilat janë në kërkim të vazhdueshëm në natyrën e pa prekur, në kontinentet dhe ishujt e largët, në fshatrat, në detet e thella, në artin lindor, religjionin dhe filozofinë, në pyjet e dendura, por edhe në traditën vetjake - sa më larg në histori dhe gjeografi - aq më mirë. Shumë nga këta udhërrëfyes nuk janë ndryshuar deri në ditën e sotme.

Siç do të shohim në vazhdim, këto pozita dhe opozita janë të gjalla edhe sot dhe paraqesin themelet dhe pika referente në të cilat kthehen edhe ithtarët edhe kundërshtarët e zhvillimit të qëndrueshëm. Mirëpo, ajo që ndryshon është vetë fuqia dhe pozita e zërave të këtyrë, nga njëra anë dhe përgjigjja në lidhje me to nga ana tjetër.³ Afërsia e njeriut me natyrën njëkohësisht do të thotë edhe se raporti ndaj natyrës si resurs kuptimi i së cilës është t'i shërbejë njeriut - është problematik, "i pa natyrshëm" dhe i gabuar.

Përfundimisht, në hapësirën politike dëgjohen edhe zërat e të tjerëve "të tjerët" të cilët gjithashtu nuk përputhen në imazhin e botës dhe njeriut të asaj kohe. Lëvizja feministe lufton që gratë të pranohen në hapësirën publike si qenie njerëzore të barabarta. Lëvizjet antiimperialiste luftojnë për lirinë e popujve dhe kulturave joevropiane, ndërsa kundër shkencës racore (Eugjenika), sundimit të robërve, padrejtësive në tregtinë ndërkombëtare dhe pushtetet kolonialiste.

Edhe pse ndërmjet këtyre lëvizjeve ekziston dallim i madh, ajo që i bashkon fillimisht janë armiqtë e përbashkët – kapitalizmi, patriarkati, industrializimi. Nga ana tjetër, të përbashkëta janë inspirimi dhe vizioni për të cilat janë në kërkim të vazhdueshëm në natyrën e pa prekur, në kontinentet dhe ishujt e largët, në fshatrat, në detet e thella, në artin lindor, religjionin dhe filozofinë, në pyjet e dendura, por edhe në traditën vetjake - sa më larg në histori dhe gjeografi - aq më mirë. Shumë nga këta udhërrëfyes nuk janë ndryshuar deri në ditën e sotme.

Siç do të shohim në vazhdim, këto pozita dhe opozita janë të gjalla edhe sot dhe paraqesin themelet dhe pika referente në të cilat kthehen edhe ithtarët edhe kundërshtarët e zhvillimit të qëndrueshëm. Mirëpo, ajo që ndryshon është vetë fuqia dhe pozita e zërave të këtyrë, nga njëra anë dhe përgjigjja në lidhje me to nga ana tjetër.

Deri në periudhën ndërmjet luftërave, ata të cilët kujdeseshin për çështjet ekologjike gjenden në margjinat e jetës shoqërore. Sociologët e ekologjisë konsiderojnë se për krijimin e lëvizjes ekologjike nevojitet të ekzistojnë një sërë parakushte.⁴ сметаат дека за настанокот на еколошко движење е потребно да постојат низ предуслови. Најнапред, треба да постои значително општествено незадоволство од состојбата во која заедницата и опкружувањето се наоѓа, со други зборови доволен број на луѓе да бидат свесни дека проблем со природното опкружување постои. Потоа, дека во таа заедница постојат и оние

³Ernst Haeckel: The evolution of Man (str. 456), Vol. 2. Apelton, New York, 1903.

⁴Për debat më të gjerë shih: Jelisaveta S. Vukelić: Mundësi për veprim dhe zhvillimin e lëvizjes ekologjike në Serbi në kontekst të transformimit post social, doktoraturë, Fakulteti Filozofik, Beograd, 2014.

кои сметаат дека проблемот може да се реши и сакаат да презemat нешто во однос на тоа прашање, како и дека располагаат со ресурси за влез во таква борба (социјални и економски ресурси, знаење и друго). Конечно, ситуацијата во општествено-politичкото опкружување би требало да создава уверuвање за можnoста за позитiven isход од таквото делување. Овде на сцената стапуваат и други политики и струи од јавниот живот кои прават некоја политичка мерка да е помалку или повеќе возможна.

Rryma e parë e rëndësishme politike e cila bashkoi shumë parime ekologjike dhe ide në bazat e ideologjisë së saj është Nacional socializmi⁵.

Sigurisht, këtu bëhet fjalë vetëm për politikë ekologjike. Që të ndodhë rritja e fashizmit dhe nazizmit nevojitet të kuptohen edhe politikat të tjera. Si e para dhe më shpesh e përmendur, është fusha e kulturës. Duke e lidhur biologjinë si disiplinë shkencore, industrializimin dhe kapitalizmin shtetëror, nacionalizmin radikal dhe shume ide të lëvizjes romantike, nazizmin e bëri të pa imagjinueshëm. Megjithatë, për herë të parë u bë diçka, dhe siç do të shohim, nuk do të jetë hera e fundit.

Sado të thella të jenë shkaqet për krijimin e këtyre regjimeve totalitare radikale, dimensionin e tyre ekologjik paraqet kapitull kryesor në historinë e politikës ekologjike. Edhe pse kjo shpesh llogaritet si pikë e zezë në tregimin e ndritshëm, ky paraqet një shembull jo shumë të vetmuar. Edhe pse ekziston mendim i rrënjosur se qëndrimi ekologjik është respektuar nga ide të tjera progresive, janë të shumta shembujt e bindjeve ekologjike të të djathtës në mbarë botën, të cilat paraqesin një vërejtje të rëndësishme se shumë argument ekologjik mund të përdoren për masa politike. përjashtuese, ksenofobe, manipuluese. Njëkohësisht, lidhjet e të djathtës me lëvizjet ekologjike e dobësuan pozitën e ekologëve dhe aktivistëve ekologjik në mbarë botën, për të cilët ekziston bindja se mbajnë pozitë liberale, se duke mbajtur llogari për natyrën maskohen çrregullimet e lirive dhe të drejtave të njeriut (që në disa raste për fat të keq është e vërtetë).

Pas Luftës së II-të Botërore, në tryezë negociatore më të rëndësishme ishin çështjet për ndërtimin e qyteteve industriale të shkatërruara, pas luftës, rritja dhe zmadhimi i numrit të popullsisë, zhvillimi ekonomik dhe ruajtja e rendit kolonizues. Në këtë periudhë në fakt u bë urbanizimi më ekspansiv dhe rritja e prodhimit industrial. Koha e artë e mirëqenies së vendeve njëkohësisht edhe koha gjatë së cilës lulëzojnë ide për para lagje ilegale, qytete të bazuara në automjete, ëndrra konsumatorë për jetën e klasës së mesme me shumicë e cila përfshin ngufatjen e ambientit natyror për shkak të argëtimit dhe zhvillimit të turizmit, por edhe të kolonializmit. Pikërisht në këtë periudhë konsumi i të gjitha energjensëve në vendet e mbarë botës shënon rritje enorme. Në planin politik ashpësohet lufta e ftohtë, zhvillohen teknologji për luftim, pushtimi i kozmosit dhe vijoje luftërat që të rruhet sa më shumë ndikimi Perëndimor i kolonive të dikurshme të cilat në këtë periudhë të "mirëqenies" bëjnë luftëra të përgjakshme për lirinë e tyre.

⁵ Mendime të udhëheqësve nacionalist e thonë këtë pohim: „ Njeriu nuk guxon të bjerë në kurthin e mendimit se kurdo qoftë i është përcaktuar të jetë zot i Natyrës“ Hitler u Mein Kampf , kapitulli, 10; «Ndjenjat e thella për natyrën gjenden në themelet e çdo kulture Goering Blatter fur Naturschutz (faqe. 18), 1935.

Si rezultat i kontradiktave të viteve të kaluara, rritet rezistenca e gjeneratave të reja ndaj idesë së këtillë për mirëqenie. **Me lëvizjet e viteve gjashtëdhjetë dhe lëvizjet natyraliste në mbarë botën, ekologjia, socializmi dhe antimodernizmi kthehen në skenën politike.** Për ekologjinë mendohet jo vetëm si raport ndaj natyrës dhe rrethinës, por edhe nga perspektiva ekologjike e cila nënkupton raport me të tjerët, e përpunon kolonializmin, patriarkatin, komunizmin, kapitalizmin dhe të gjithë projektin modern.

Gjatë viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë, në mbarë botën Perëndimore, hapen ministri për ekologji dhe mjedis jetësor. Çështja e ekologjisë bëhet një nga më të theksuarat çështje politike, por në atë moment, konsensusi rreth çështjeve ekologjike nuk ekzistonte. Në spektrin e politikave ekologjike, nga njëra anë gjenden zërat radikale të cilat udhëhiqen nga supozimi se për ndryshim ekologjik nevojitet transformim themelor ekonomik dhe social i cili duhet ti përfshijë shumicën nëse jo të gjitha institucionet e civilizimit momental - ideja e shtetit, teknologjisë dhe tregut. Një nga pikëpamjet themelore të kësaj pozite është se me përdorimin e veglave të njëjta nuk mund të krijojmë rezultate ndryshe. Projekti modern i cili e krenon shkencën, teknologjinë, prodhimin industrial, racionalizmin, individualizmin dhe konkurrencën, i cili paraqet ndarje të qartë të kulturës dhe natyrës, nuk është në nivel të detyrës të transformojë civilizimin njerëzor në drejtim të komunitetit më të përgjegjshëm ekologjik, konsiderojnë këto pozita. Nga ana tjetër e spektrit gjenden ata të cilët mendojnë se institucionet aktuale mund të ofrojnë përgjigje për krizën ekologjike perspektive. Ata ofrojnë zgjidhje në formë të barrierës për prodhimin, vendosjen e filtrave dhe kufizime për ndotësit dhe nxitja e masave për mbartjen dhe ekspansionin e resurseve natyrore. Edhe dallimet në këto pozita janë të konsiderueshme, të gjithë ithtarëve të pothuajse spektrit të kompletuar të politikave ekologjike u është e qartë se ndryshimi i raporteve ndaj rrethinës duhet të përfshijë uljen e rritjes ekonomike. Konferenca në Stokholm e vitit 1972, më shumë merret me *kufijtë* e rritjes ekonomike.

Në fushën e politikave sociale, dekada pas Luftës së Dytë Botërore, gjithashtu është e qartë se rritja ekonomike duhet të kontrollohet nga shteti që të jetë në përputhje me prioritetet e tjera shoqërore. Që nga periudha pas luftës, për politikanët u bë e qartë se shteti nuk guxon të lërë ndarjen e pasurisë ndërmjet kompanive të mëdha dhe bursave. Edhe pse janë neoliberalë, politikave ekonomike në formë të neokolonializmit të imponuara në shumë ish koloni dhe vende "në zhvillim" gjatë viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë, mirëqenia shtetërore ka numër të madh të ithtarëve "nga vendi" dhe është vështirë të zhbëhet brenda natës. Megjithatë, financuesit kryesorë të mirëqenies shtetërore – industrinë e mëdha dhe bizneset – asnjëherë nuk kanë qenë mbështetës të idesë për shtet të madh i cili mund të sigurojë përfitime sociale, shëndetësore, kulturore dhe arsimore për qytetarët, me dekada korporatat e mëdha bashkëpunojnë me shtetet në suazat e projekteve për ekstraktim të profitit nga fqinjët, vendet ideale dhe kolonitë. Mirëpo, shumë koloni janë humbur, ndërsa shtetet e reja të krijuara vendosin mbrojtje për ekonomitë e tyre në firmë të tatimeve dhe doganës për kompanitë ndërkombëtare. Si përgjigje ndaj kësaj, kompanitë e mëdha fillojnë në mënyrë plotësuese të zmadhohen nëpërmjet bashkimit dhe qiramarrjes, bëjnë karte globale, gjejnë strehimore

tatimore në formë të shteteve të vogla klienteliste dhe nëpërmjet hapësirës mbi nacionale kryejnë presion mbi qeverinë e tyre që ti ulë tatimet, ti heqin taksat dhe luftojnë për heqjen e doganave dhe normave të tjera në tregtinë ndërkombëtare. Njëkohësisht bëhet betejë ideologjike kundër vetë idesë për shtet dhe të mirë publike, sugjerohet në jo efikasitetin e shtetit të madh dhe kinse ngufatjen e lirisë së tregut dhe kështu krijohet hapësirë për krijimin e politikës së re.

Ardhja e Ronald Reganit dhe Margaret Taçerit në pushtet në SHBA dhe Britaninë e Madhe në vitet e tetëdhjeta do të thoshte triumf për politikën të cilat u shkonin për dore mega korporateve. Me to ndryshohet klima politike dhe *mejstrimi* i politikës botërore kthehet në mënyrë eksplicite kah neoliberalizmit. Në thelb të neoliberalizmit gjendet para së gjithash dhe rregullimi i tregtisë ndërkombëtare me mall dhe kapital, privatizimi, zvogëlimi dhe shteti social me arsim të qashtëm, shëndetësi, kulturë dhe vendosja dhe lëshimi i këtyre fushave në treg respektivisht në duart e lojtarëve më të fuqishëm në të. Me fjalë të tjera, me largimin e kufizimeve të mundshme për rritjen e profitit. Mirëpo, në momentin e instalimit, këto politika kanë numër të madh të kundërshtarëve në nivel global, para së gjithash në Evropë ku ekziston traditë e fuqishme e shtetit social dhe në Amerikën Latine e cila shërbente si zonë për testimin e politikave neoliberale.

Duke e parë në tërësi politikën globale, politika e zhvillimit të qëndrueshëm paraqet para së gjithash përpjekje të qetësohen politikën antagoniste sociale dhe ekologjike me qëllim qetësimin e pa kënaqësisë shoqërore. Si kritikë më e madhe për neoliberalët vjen në llogari të drejtësisë sociale dhe pabarazisë, dekolonializmit dhe raportit ndaj mjedisit natyror, detyra ka qenë të gjendet mënyrë, ato të shpiken në mënyra të cilat nuk e prekin rritjen e papenguar ekonomike. Shumë shpejtë i gjithë spektri politik u hegjemonizua dhe zhvillimi i qëndrueshëm si një nga shumë vizionet e politikave ekologjike, sociale dhe ekonomike fillon të dominojë. (10) Ky version shkëputet me raportin e deritanishëm negativ ndaj profitit i cili jo vetëm që përfshihet në idenë e qëndrueshmërisë, por në idenë e qëndrueshmërisë e zë vendin e parë. Në suazat e politikave neoliberale, çështja nuk është në cilën mënyrë të shpikët rregullimi ekonomik i cili do të mundësojë barazinë shoqërore dhe qëndrueshmërinë ekologjike, por si të rregullohet i gjithë sistemi në të cilin rritja ekonomike dhe përfitimi nuk do të jenë çështje. Pikërisht ky fiksion i përfitimit si supozim kryesor i sistemit e përbën thelbin e konceptit për zhvillim të qëndrueshëm.

Dokumenti më i rëndësishëm i kësaj politike “E ardhmja jonë e përbashkët” është publikuar në vitin 1987 nga Brundtland Komisioni.⁶ Ai me vete mbart përkufizimin më shpesh të cituar se zhvillimi i qëndrueshëm është ai zhvillim i cili i kënaq nevojat e të tanishmes pas cenuar gjeneratat e ardhshme të kënaqin nevojat e tyre. Mirëpo, ajo që është shumë e rëndësishme është konteksti në të cilin krijohet dhe disa nga mekanizmat kryesorë të cilët i propagandon. Kontributi më i madh është ai që në vend të rritjes ekonomike brenda në konceptin e ekologjisë dhe kujdesit për mjedisin, respektivisht ajo që synon të betonizojë strukturat shoqërore. Sipas raportit, çështja e krizave ekologjike është çështje e nevojave në rritje të popullatës që po shtohet në suaza globale.

⁶Brundtland, G. H., & Khalid, M.: Our common future. New York, World Commission on Environment and development, 1987.

Nuk bëhet fjalë për arsyetimin e atyre nevojave dhe për mekanizmat e shoqërisë konsumatorë dhe prodhimit kapitalist të cilët i prodhojnë ato nevoja. Çështja e të varfërve para së gjithash është çështje e rritjes së madhe të popullatës dhe mungesës së teknologjive të cilat do të prodhojnë mjaftueshëm për të gjithë. Kjo nuk ndërlidhet me shpërndarjen jo të drejtë të resurseve në nivel global dhe nacional të cilat janë pasojë e llojeve të ndryshme të eksploatimit përfshirë edhe kolonizimin.

Raporti me vetë titullin sugjeron hapësirë “postideologjike” në të cilin nuk ekzistojnë dallime ideologjike (të cilat nuk përmenden) dhe sugjerohet bashkimi dhe homogjenizimi i të gjithë banorëve të planetit dhe përgjegjësi kolektive dhe pozita e të gjithëve që ndajnë “të ardhmen tonë të përbashkët”. Nuk përmenden gjithashtu mospajtimet, dallimet dhe raportet e pabarabarta të fuqisë në shoqëri. Përfundimisht, ajo që përjashtohen nga imazhi janë të gjitha kërkesat të cilat i karakterizojnë lëvizjet e ndryshme kundërshtare që nga shekulli nëntëmbëdhjetë dhe të cilat përfshijnë vendosjen e themeleve të perëndimit, shoqërive industriale, propozohet ekonomizim më i mirë dhe menaxhim me resurset ekzistuese dhe zhvillimin i teknologjive të reja të cilat dihet të sigurojnë para së gjithash, siç shkruan edhe në dokument "erë të re të rritjes ekonomike".⁷

Për temën me të cilën po merremi këtu, mesazhi kryesor i këtij raporti, por edhe i gjithë koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është raporti shoqëror të mos ndryshojë – çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm nuk janë çështje të rregullimit shoqëror, por çështje të metodës dhe mënyra të vërejtjeve të krizave ekologjike, ekonomike dhe sociale. Supozimi kryesor është se projekti modern do të na nxjerrë nga problemet në të cilat na futi. Kjo është ajo që në literaturë shpesh quhet “menaxhializëm ekologjik” (environmental managerialism), i cili nënkupton se marrësit e vendimeve miratojnë masa për mbrojtjen e mjedisit të lejuara të mund të refuzojnë kritikën se nuk punojnë asgjë, por vetëm në atë masë me të cilën nuk do të cenon rritjen ekonomike dhe të ndryshojnë pozitën e fuqisë.⁸

Gjatë viteve nëntëdhjetë, të gjithë armiqtë më të mëdhenj të kapitalizmit janë të ngufatur ose u ngufatën vetë. Vendet komuniste në lindje të Evropës dhe në Azi lidhen ndaj procesit tradicional dhe përfitimit të institucioneve kapitaliste. Në mendimin publik, kapitalizmi ia del të identifikohet me demokracinë, tregun e lirë, ndërsa shteti i fuqishëm me korrupsionin dhe jo efikasitetin, komunizëm me izolim dhe kontroll. Në shkrimet e promotorëve të këtyre politikave, bota hyn në faza post ideologjike. Përjetohet "fondi i historisë", që do të thotë fund i konflikteve. Projektohet botë e ekuilibruar dhe idile globale e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në skenë dalin disa politika të reja në të cilat kreativiteti, optimizmi dhe sipërmarrësi luajnë rol kryesor. Në fushën e teknologjisë, sundon teknoeuforia me përmasa të papara. Mediat e reja si garant i lirës së shprehjes, interneti dhe telekomunikimet si mundësi për integrim global, bioteknologjia dhe kiborzi si segment të, njeriut të ri më të mirë të pangarkuar nga pengesat biologjike - e gjithë kjo premtori të ardhme të ndritshme për njerëzimin i cili tani i pa ngarkuar nga konfliktet ideologjike mund

⁷Njëjtë

⁸Timothy Luke: Eco-managerialism: environmental studies as a power/knowledge formation. In Living with nature: Environmental politics as cultural discourse (f. 103-120), 1999.

të lundrojë në fazat e paqes dhe stabilitetit. Problemi i ndotjes ekologjike është problem vetëm i prodhimit të pa mjaftueshëm efikas.

Koncepti i industrive kreative me vete bart premtime se ekonomia dhe arti janë shpirtra të ngjashëm dhe se nëse më mirë lidhen mund të bëhen kreativ ndërsa arti profitabil. Qeveritë perëndimore kanë një vetëbesim të ri që sugjeron trendi i ri i matjeve, përcjelljes dhe nxitjes së gëzimit i cili brenda natës nga fusha e asaj private kalon në fenomen publik. Teknootimizmi dhe kreativiteti i përfshin edhe fushën e ekologjisë. Dominon bindja se problemet ekologjike jo vetëm që nuk janë pengesë e rritjes ekonomike, por mund të jenë kurthi i ri për rritje dhe zhvillim. Kreativiteti i ri i cili është i nevojshëm që të prodhohen teknologji të gjelbra (automobil elektrik dhe hidro dhe transport publik, shtëpi inteligjente që kursejnë, energji diellore dhe energji me erë dhe të tjera) dhe të jenë të qasshme dhe të shpërndahen që të bëhet ekonomia edhe më kompetitive, që të rritet produktiviteti.

Në këtë periudhë qyteti ndahet si terren për politika të zhvillimit të qëndrueshëm.

Dy shkaqe veçohen si kryesore. Me rritjen e popullatës, industrializimit dhe urbanizimit të Jugut global, qytetet bëhen vende të cilat njëkohësisht prodhojnë më shumë ndotje për të gjithë planetin dhe bëhen më të pa shëndetshme për të jetuar. Pas samitit në Rio, 1992, qyteti është prezantuar si fushë kryesore e luftës për zhvillim të qëndrueshëm, ndërsa Agjenda 21 është miratuar në qindra qytete në mbarë planetin.⁹ Kështu u krijua ideja për qytet të qëndrueshëm, ndërsa në themelet e saj gjenden të gjithë elementët kryesor të politikës neoliberales: Zvogëlimi i burokracisë qytetare, partneriteti privat-publik, nxitja e sipërmarrjes dhe investimeve, menaxhimi i politikave lokale dhe individualizimi i përgjegjësive të bizneseve kreative, aktive, qytetarë sipërmarrës dhe biznese të vogla.

Pamja optimiste e cila është e hapur dhe e projektuar në vitet nëntëdhjetë nuk u mbajt kohë të gjatë në realitet. **Bota nuk përputhet me imazhet me të cilat duan ta sqarojnë.** Në qytetet, më shumë se kudo, u bë e qartë se rritja ekonomike në praktikë do të thotë krijimin e jo barazisë shoqërore dhe shkatërrimin e mëtejshëm të mjedisit jetësor. Ngrohja globale vazhdoi me intensitet edhe më të madh, ndërsa kuotat e dhëna për prodhimin e ndotjes nuk ishin plotësuar aspak.¹⁰ Kolonizimi i natyrës vazhdon si dhe shkatërrimi i të tjerëve. Sulmet terroriste të 11 shtatorit, "luftërat kundër terrorizmit" në Lindjen e Aafërme "Pranvera Arabe", lufta në Ukrainë - të gjitha kanë të përbashkët se krijojnë truall për raport kolonizues më shumë shekullor ndaj komuniteteve "më pak të zhvilluara". Përfundimisht dështimi financiar i vitit 2008 dhe recesioni treguan se rritja ekonomike e pa kontrolluar nuk është e mirë as për rritjen ekonomike. Të gjitha këto ndodhi globale gjatë dy dekadave të fundit njëkohësisht treguan se jo qëndrueshmëria e "zhvillimit të qëndrueshëm" dhe politikat neoliberale urbane, ekologjike, sociale dhe të tjera në mënyrë plotësuese e konfirmoi dobësinë politike të të gjitha alternativave. Në vend të kësaj i gjithë spektri politik pajtohet me pikëpamjen e padyshimtë të rëndësisë së rritjes ekonomike, raportin eksploatues ndaj natyrës, raportin kolonizues ndaj

⁹Shiko më tepër në: Brand, P. and Thomas, M.: Urban environmentalism: global change and the mediation of local conflict, Routledge, 2013.

¹⁰IPCC: Fifth Assessment Report - Impacts, Adaptation and Vulnerability, Intergovernmental panel on climate change, 2014. Gjendet në: <http://www.ipcc.ch/report/ar5/wg2/>

popujve të tjerë, liria e tregut, rruajtja e lirive ekonomike të cilat në praktikë do të thonë shtresim i mëtejshëm, zvogëlimi i shtetit dhe premisa të tjera të kapitalizmit neoliberal.

Megjithatë, krizë pas krize i detyron qendrat e vendimmarrjes dhe fuqisë për të gjetur mënyra të reja të vetë mbajtjes. Përgjigja e tyre është menaxhimi i krizës, gjegjësisht menaxhimi me shoqërinë e rreziqeve.¹¹ Nga njëra anë shpesh projektohen armiq nga të cilët duhet të frikësohemi - mbi të gjitha, natyra dhe të tjerat të padëshiruara. Nga ana tjetër, mbrojtja prej "tyre" duhet të na bashkojë "neve" dhe njëkohësisht t'i anashkalojë të gjitha dallimet e rëndësishme mes nesh, siç është për shembull pabarazia shoqërore dhe ekonomike. Kjo manovre, e shtyn hapësirën politike globale në gjendje të jashtëzakonshme që ka për qëllim të pamundësojë çfarë do shqyrtim të shpikur të alternativave dhe ta arsyetojë ngufatjen e tyre. Ajo që krijohet, shumë teoricienë e quajnë hapësirë "post-politike"-hapësirë në të cilën ngulfaten të gjithë zërat që kundërshtojnë, që të mund të vazhdohet sipas të vjetrës.

Mesazhi i kësaj historie të shkurtë për të gjithë ata që luftojnë për qytete më të barabarta, më të përgjegjshme dhe më të shëndetshme është çdo zgjidhje në fushën e teknologjisë dhe menaxhmentit nga ndonjë aspekt të funksionimit të qyteteve dhe shoqërive të mund të bëhen instrument për betonimin e renditjes shoqërore dhe pamundësimi i ndryshimeve në afat më të gjatë përderisa nuk merret para sysh interpretimi i pasojave më të gjera kulturore, politike dhe shoqërore nga kjo zgjidhje. Njëkohësisht, mesazhi është se qyteti i qëndrueshëm para së gjithash duhet të jetë i hapur në mënyrë politike, për hapësirë demokratike për përfaqësim të lirë, të shprehurit dhe bashkëpunimin e ndërsjellë se në të kundërt, ekologjia dhe zhvillimi i qëndrueshëm bëhen ideologji represive.¹²

Mite mbi zhvillimin e qëndrueshëm

Pika e nisjes në këtë tekst, si dhe për të gjithë projektin Act4citz është fakti se ndryshimi në qytete është i domosdoshëm. Dy pyetjet kryesore janë: Çfarë ndryshimi na nevojitet dhe si mund ta bëjmë atë ndryshim. Për të dyja pyetjet para së gjithash është e rëndësishme kush dhe në ç'mënyrë merr pjesë në vendimmarrjen se çfarë ndryshimi të iniciojë. Ekziston një mendim në shoqëri se fuqinë e tërësishme e kanë politikanët dhe kapitalistët e mëdhenj, nga vendi dhe të jashtëm, dhe se gjithçka është në duart e tyre.

Roli i aktivistëve, ekspertëve, artistëve është të prekin disi tek ato vende të vendimmarrjes dhe të japin idetë e tyre. Pa marrë parasysh a është kjo gjë e vërtetë apo jo, kjo është një pamje shumë problematike e politikës si një bojler ku rrjedh uji dhe i politikanë si ventile të cilët vendosin se çfarë do të kalojë dhe çfarë nuk do të kalojnë. Në këtë fotografi harrohen një numër i madh kanalesh, mënyrash dhe hapësirash të tjera të intervenimit dhe krijohet raport klientelist midis përfaqësuesit të ndryshimeve dhe marrësit të vendimeve, kurse njëkohësisht të gjithë aktorët e

¹¹Shiko: UlrihBek: Rizičnodruštvo, Beograd, Filip Višnjić, 2001.

¹²Zhizhek dhe Bagji kanë sugjeruar se ekologjia është opiumi i ri për masat. Shiko më tepër në: Slavoj Žižek: Ecology – A New Opium for the Masses, Nextnature.net, 2009. Gjetet në: <https://www.nextnature.net/2009/02/ecology-a-new-opium-for-the-masses/>

tjerë nisen nga fotografia. Siç është përmendur tashmë, për të ardhur te ndonjë ndryshim i cili mund të ndikojë në vendimmarrjen, është e nevojshme të ndryshojnë marrëdhëniet ekzistuese në shoqëri, për të krijuar shprehi të reja të mendimit dhe veprimit, dhe për të ndërtuar hapësira të reja dhe mënyra të interpretimit dhe veprimeve të përbashkëta. Pra, ndryshimi nuk duhet të bëhet vetëm në relacionin ekspertë-politikanë, por edhe në një rrjet shumë më të koklavitur të marrëdhënieve.

Në atë ndryshim, rol të rëndësishëm kanë pikërisht aktivistët, qytetarët, analistët, gazetarët dhe faktorët e tjerë në shoqëri. Kështu që ajo të cilën e mendojnë, besojnë dhe punojnë është me rëndësi të madhe. Ekzistojë njohuri dhe besime që mund të jenë inkurajuese dhe përforcuese, si dhe të tilla që mund të jenë penguese dhe të largojnë dikush nga përpjekjet e mëtejshme. Në këtë pjesë ne do të përqendrohemi pikërisht në disa prej besimeve dhe qëndrimeve të atyre që përpiqen për qytete të ndryshme; te besimet që theksojnë se janë të rëndësishëm për ndërtimin e qytetit të qëndrueshëm, por në të njëjtën kohë i largojnë qytetet nga hapësira politike - hapësirë për mosmarrëveshje, jetë shumëdimensionale dhe politika përgjegjëse. Shumë mite¹³ të cilat do t'i diskutojmë këtu, janë të pranishme në punën dhe gjuhën publike të një numri të theksuar organizatash aktiviste të cilat kanë marrë pjesë në aktivitete të shumta të projektit Act4City. Për disa prej tyre, bashkësi shkencore nga fusha të ndryshme, tashmë një kohë të gjatë shkruajnë dhe flasin për faktin se ku ekziston ai bashkim, kurse lexuesit i drejtojnë kah burimeve. Megjithatë, këto mite nuk janë gjetje shkencore dhe këtu nuk jepen pohime ekzakte për shpeshësinë dhe shpërhapjen e këtyre besimeve. Më tepër bëhet fjalë për shumë shpjegime të përzgjedhura për problemet e mendimit momental të politikës urbane, ekologjike. Lexuesit lihen që të vlerësojnë vetë cilat mite i konsiderojnë si funksionale dhe relevante dhe cilat jo.

Por kjo është e tmershme!

Miti i cili siguron lëndën djegëse për të gjithë projektin e zhvillimit është miti për fund të shpejtë. Datat apokaliptike që paralajmërohen në disa vitet e fundit, pamjet shqetësuese prej pyjeve të shkatërruar, akullnajat e gjelbëruar dhe rajonet e thata, pohimet për “fundin e civilizimit siç e njohë” dhe shfaqjen distopike për të ardhmen po na rrethojnë gjithnjë edhe më shumë, nga ekranet e kinemave deri në revistat e njohura shkencore, nga lajmet, nga letrat elektronike virale dhe nga bllogjet. Nga të gjitha anët rekomandohet, nëse nuk ndërmerret asgjë na pret një fund i pashmangshëm dhe i shpejtë. Në këtë situatë të jashtëzakonshme e cila po krijohet, nuk kemi kohë dhe mundësi për bisedime, mendime, pikëpamje personale dhe filozofim. Mundësia e vetme është intervenimi nga lart dhe dëgjueshmëria nga poshtë. Fëmijët mësohen të blejnë gjëra të riciklueshme dhe organike, jepen kredi të volitshme për panele diellore dhe subvencione për automobila elektronike – praktika të konsumatorëve me ngjyrë të gjelbër. Po bëhen një sërë përpjekjesh marginale të

¹³Mënyra se si do të përdoret termi mit këtu nuk implikon se miti duhet me patjetër të përfaqësojë pavërtetësi (edhe pse ai është i tillë). Në të vërtetë, këtu e vërteta nuk është kategori kryesore. Është e rëndësishme t'i besohet në diçka si në të vërtetën dhe mendimin dhe veprimin e vet ta formojë në bazë të kësaj. Miti është krijuar pa dallim se cilat janë argumentet në dobi të (pa)vërtetësisë të fjalimeve (edhe pse argumentet janë gjithmonë të mirëpritura). Ajo që do të analizohet këtu janë pasojat politike, etike dhe ekologjike nga ky besim.

cilat duhet të mundësojnë që të qetësohet bota, kurse frika të mos e tejkalojë kufirin ku ngrihet rebelim serioz.

Megjithatë, duhet të dihet se përparimi frikës është një prej strategjive kryesore bashkëkohore për sundim.¹⁴ Në lojën e tillë politike, shqetësimi i sinqertë përdoret për prodhim të frikës dhe servilizmit, kurse nevoja për interpretim të bazuar të çështjeve komplekse për rendin e qytetëruar shtyhet për një kohë pas krizës. Pas skenës ku ndodh drama ekologjike të cilën e mbikëqyrim me lemeri dhe ndjenjë të pafuqisë, punët zhvillohen pa u ndryshuar.

Po të mos jenë ata ne do të ishim më mirë...

Përveç frikës prej fatkeqësive natyrore, frika kryesore vjen nga të tjerët të cilët përkufizohen si palë kulturologjike. Në periudhën pas Luftës së Ftohtë, në vend të komunistëve, rolin e piratëve të tmerrshëm tani e luajnë arabët, myslimanët, meksikanët, kinezët, indusët, polakët, serbët, shqiptarët, fshatarët dhe të paditurit, dembelët dhe jopunëtorët dhe “grupacioneve të tjera problematike” si dhe në varësi nga pozita gjeopolitike e atyre të cilët orientojnë drejt rrezikut. Ata vendosin bomba, vjedhin, marrin punën apo ndihmën sociale dhe në mënyra të tjera e rrezikojnë ndjenjën e sigurisë së qytetarëve, Sipas rregullit, të gjithë ata, cilët do qofshin, e pengojnë dhe e bëjnë të pamundur zhvillimin shtetëror. Me dekada flitej për problemin e rritjes së popullatës, Po të mos jenë kinezët, indianët dhe popujt e tjerë, kryesisht aziatikë dhe afrikanë, do të ishim më pak në planet, prandaj do të ishte më e lehtë – ka qenë argumenti. Tani kur u zvogëluar rritja e popullatës, sugjerohet se problemi qëndron pikërisht te të njëjtat shtete të cilat nuk sillen në mënyrë ekologjike, shpenzojnë shumë beton, i presin pyjet e tyre dhe e ndotin planetin (edhe pse e dimë se ndotja për banor lidhet drejtpërdrejt proporcionalisht me pasurinë e një shoqërie). Në planin e zhvillimit ekonomik, pohohet se ekonomitë perëndimore do të ishin më stabile, kurse shtetet do të ishin më të fuqishme nëse nuk do të kishin një fluks të tillë të pandalshëm të migrantëve të cilët vjedhin punën, nuk paguajnë tatime dhe punojnë në të zezë. Këtyre argumente gjithmonë si mëlmesa u shtohet dhe njëfarë pakulture dhe prapambetje qytetare dhe gabueshmëria.

Si në rastin me CO₂, shtetet dhe korporatat prodhojnë njëkohësisht probleme dhe propozojnë vetveten si mbrojtës. Kjo në bazë është diskurs i famshëm i cili njëkohësisht e bashkon popullin, i mbytet të gjitha dallimet dhe mosmarrëveshjet dhe e tregon armikun e jashtëm si burim të problemit dhe me vetë këtë e legjitimon si objektiv. Detyra kryesore është përgjegjësia për prodhim të prodhim të problemit të fshihet dhe të legjitimohet uzurpimi i fuqisë dhe përdorimi i fuqisë. Prandaj është e rëndësishme të shihen me sy kritik, çështjet që promovohen, si dhe zgjidhjet dhe mbrojtjet të cilat propozohen, akoma më tepër për shkak të faktit se mbrojtjet shpesh kanë si pasojë ngushtimin e të drejtave qytetare. Nëse frika është kapitali me të cilat mbahet *status quo*, atëherë prodhimi i frikës nuk duhet të jetë qëllimi i atyre të cilët dëshirojnë me të vërtetë ndryshim.

¹⁴Më tepër mbi rolin e frikës, rrezikut dhe mbrojtjes së politikës bashkëkohore shiko, midis të tjerash në: Isabell Lorey: State of insecurity: Government of the precarious, London, Verso Books, 2015.

Politikanët tanë të paditur janë fajtorë për gjithçka!

Pyetjet për zhvillimin sipas rregullit përjetohen si hiperkomplekse. Kjo njëkohësisht do të thotë se me to duhet të merren vetëm ata të cilët mund të kuptojnë dhe interpretojnë realitetin e koklavitur. Njëkohësisht, ekziston bindja se këtë aftësi kryesore nuk e posedojnë pikërisht ata të cilët i marrin vendimet më të rëndësishme, prandaj njohuritë e tyre bëhen pengesa kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm. Në mjedisin tonë, vërejtja më e madha që u bëhet politikanëve është pikërisht kjo se janë joprofesionalë, të paditur dhe të paorientuar. Ajo që sugjerohet është se ata me më tepër njohuri do të merrnin vendime të cilat janë më të mira për të gjithë ne. Nëse e shohim pak më mirë realitetin, kjo nuk është vetëm një pritje naive, por edhe shumë e pabazë historikisht, kurse ndërkohë praktika e udhëheqjes së politikës nuk ka ndryshuar. Problemi i keqpërdorimit të fuqisë politike nuk është se mungon ekspertiza, por nga mungesa e transparencës, manipulimet e ndryshme, korrupsioni, dobësia e sektorit civil dhe mediave dhe gjithçka tjetër që çon në mosrespektimin e interesit publik dhe përvetësimin e të mirave publike.

Ekspertët duhet të pyeten!

Në rrugën e shoqërisë postpolitike, shoqëria ku nuk vlerësohen të mirat publike dhe debatin publik, rol të rëndësishëm luajnë dhe ata të cilët jo rrallë pritet që ta rregullojnë më mirë punën – ekspertët. Këtu bëhet fjalë për një mit të shpërhapur gjerësisht se ekspertët mund dhe dinë si ta zgjidhin problemin (të çdo lloji) vetëm nëse u lihen duart e zgjidhura që ta bëjnë atë. Ekoekspertët në dekadën e fundit kanë marrë statusin e yje, të prezantuar si shpëtuesit të cilët futen nëpër pyjet e thella dhe akullnajat e largëta, si heronj të ri të patrembur që luftojnë për interesin e përgjithshëm. Megjithatë, me lartësimin e tyre në publik prodhohen njëkohësisht edhe disa pasoja shumë dëmtoese. Së pari veçantia e tyre në aspektin e njohurive dhe guximit vendos gjetje me të cilat ata vijnë në fronin e paprekshmërisë.

Së dyti, reflektimet dhe veprimet e “qytetarëve të zakonshëm” vlerësohen dhe ata dekurajohen që të reflektojnë mbi çështjet të cilat janë kaq të koklavitura, si për shembull ndryshimet klimatike për të cilat edhe superkompjuterët më të fuqishëm në botë nuk janë profesionalistë sa duhet.

Së treti, krijohet përshtypja se shoqëria i mbështet dhe shpërblen përpjekjet e tilla, që është e mjaftueshme. Megjithatë, gjetjet dhe rekomandimet e atyre ekspertëve nuk miratohen ose miratohen në mënyrë selektive, kurse me të dhënat manipulohet për shkak të realizimit të disa interesave të pjesshme. Edhe ekspertët e tjerë nga fusha e zhvillimi të qëndrueshëm marrin një qëndrim të ngjashëm. Ekonomistët mbajnë monopolin e interpretimeve të të gjitha çështjeve ekonomike. Ekonomia prej një kohe të gjatë prezantohet si shumë e koklavitur që qytetaria të merret me politikën ekonomike. Qytetarët janë këtu që të paguajnë tatimin dhe të marrin kredi, nëse u rekomandojnë kështu ekonomistët.¹⁵ Urbanistët mund të miratojnë plane për zhvillim të qytetit të cilat në afat të gjatë u konvenojnë investitorëve, duke u arsyetuar se qyteti është organizëm kompleks dhe se vendime të caktuara kanë

¹⁵Nuk duhet të harrohet se në të gjitha krizat rol shumë të madh kanë luajtur bankarët të cilët me legjitimitet e ekonomistëve u kanë rekomanduar qytetarëve që të marrin kredi edhe pse për ta kjo nuk ka qenë e rekomandueshme.

kuptim vetëm nëse kuptohet pamja më e gjerë. Edhe profesione të ndryshme (sociologë, psikologë, arkitektë, ndërtues...) në fushat e veta disa çështje i profesionalizojnë dhe disa tema të caktuara i privatizojnë: gjetjet e tyre, edhe pse mund të jenë shumë të mira dhe të dobishme, në vetvete mbartin rrezik, nga njëra anë keqpërdorim, kurse nga ana tjetër ia mbyllin gojën debatit të gjerë publik mbi temat me të cilat merren. Pikëpamja e ngushtë profesionale e shoqërisë dhe të mirave publike, sado që të jetë e thelluar në suazat e një fushe të ekspertizë, nuk e njeh shumëllojshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e problemeve të strukturuar dhe promovon zgjidhje njëdimensionale.

Për shkak të këtyre problemeve, është e rëndësishme problematikën e menaxhimit me shoqërinë ta shqyrtojmë jo vetëm si çështje eksperte të mbrojtjes së llojeve të kafshëve dhe bimëve, prodhimit të energjisë dhe riciklimit, menaxhimit me normat e kamatave, planifikimit hapësinor, ndërtimtarisë dhe rregullimin e ligjeve, por edhe si çështje për jetën e përbashkët të njerëzve, makinerive, bimëve, kafshëve dhe materies jo të gjallë në planet. Kjo është një çështje e cila kërkon përgjigje të cilat mund t'i japin rrathët më të gjerë dhe jo vetëm ekspertët dhe intelektualët, por edhe qytetarët dhe qytetaret pa marrë parasysh kompetencën e tyre. Kjo nuk do të thotë hedhje poshtë e ekspertizës dhe lavdërim i "urtësisë së masave"¹⁶, por mbrojtje e interesit publik dhe hapësirës për debat publik prej mbylljes në rrathë të ngushtë ekspertësh nga cilido specialitet.

Kurse ne të gjithë në të vërtetë e duam të njëjtën gjë

Thelbi i postpolitikës, është largimi i konflikteve si vjetërsira, si ndonjë trashëgimi e padëshiruar e të kaluarës së zyrtë ku kanë ekzistuar ende klasa, ideologji dhe "marrëzira të tjera të panevojshme".¹⁷ Elitat e reja politike na bindin se është koha të shkojmë përpara. Na pret bota e zhvillimit të qëndrueshëm ku nuk ka nevojë për konflikte, sepse ne të gjithë në vetvete e duam të njëjtën gjë: gjithçka që i nevojitet njeriut normal. Siç u fol edhe më parë, zhvillimi i qëndrueshëm ka ardhur pikërisht s zgjidhje e përplasjeve shoqërore në nivel të shteteve dhe globalisht. Për shkak të këtij diskursi zhvillimi i qëndrueshëm promovon sidomos thjeshtëzim dhe skematizim të pamjeve të Natyrës dhe Njerëzimit. Në diskurse të tilla – Njerëzimi përfaqëson masë homogjene të individëve të cilët, edhe pse konfrontohen këtu e bëjnë vetëm për fenomene sipërfaqësore. Ekziston besimi, se të gjithë ne njerëzit, rreth gjërave thelbësore, në të vërtetë jemi dakord. Cilat janë ato gjëra, flitet rrallë, ashtu siç përmenden rrallë alternativat e ndryshme të jetesës, rregullimi i bashkësive dhe lëvizjeve në Natyrë.¹⁸ Në këtë mënyrë ngushtohen vazhdimisht mundësitë për ndryshim të marrëdhënieve shoqërore dhe shpërndarja e fuqisë. Pa marrë parasysh në cilën mënyrë "ne" krijohemi si grup homogjen - a jemi të gjithë "njerëz" apo

¹⁶Urtësia e masave lidhet me lëvizjen Web 2.0 e cila prej përdoruesve të internetit në të vërtetë bën punëtorë pa pagesë. Për më tepër shih: Giles: Wisdom of the Crowd. *Nature*, 2005. Zakritiku: Coleman, S., & Blumler, J. G.: The wisdom of which crowd? On the pathology of a listening government. *The Political Quarterly*, 82(2011).

¹⁷Këtu termi postpolitik është i rëndësishëm dhe e kanë përpunuar detajisht Chantal Mouffe: On the political. Psychology Press, 2005 Или Jacques Rancière, Hatred of democracy, London, Verso, 2006.

¹⁸Disa autorë do të përmendnin dhe fshirjen e tërësishme të kufijve midis natyrës dhe kulturës dhe propozojnë dekolonizim të natyrës si objekt për njohje, kontroll dhe formësim. Shiko më tepër në: Demos, T. J.: "Decolonizing Nature: Contemporary Art and the Politics of Ecology." *Critique d'art, Livres par auteur*, 2016. Këtu termi postpolitik është i rëndësishëm dhe e kanë përpunuar detajisht: Chantal Mouffe: On the political. Psychology Press, 2005.

viktima të dikujt apo diçkaje mbi të cilën nuk mund të veprojmë (“të fuqishëm” “mbifuqi”, apo diçka tjetër) – çdo fjalim që sugjeron se ne në të vërtetë jemi të gjithë të njëjtë është i rrezikshëm sepse e mbyll hapësirën për bisedime dhe gjetjen e zgjidhjeve të reja. Kështu hapësira publike u lihet atyre të cilët kanë më tepër fuqi, kurse nevoja për të tjerët në të vërtetë nuk ekziston sepse “atë që e flet një njeri e mendojnë të gjithë njerëzit e tjerë”.¹⁹

Qytetarët tanë të jenë më pak aktivë...

Midis atyre të cilët konspirojnë ndryshime në qytete, përveç ankimit për politikanët dhe pozitën e keqe të ekspertëve, është i shpeshtë mendimi se as qytetarët nuk janë në lartësinë e duhur të detyrës për zhvillim të qëndrueshëm. Me fjalë të tjera, ekziston në masë të madhe miti i gdhendur se qytetarët janë letargjikë, pasivë dhe të papërgatitur që të lëvizin. Si fajtor i zakonshëm për këtë thuhet se është “mungesa e vetëdijes” te ta. Së pari, është e rëndësishme të shihet se ajo që qytetarët nuk duan të ngrihen për ndonjë qëllim të caktuar, nuk do të thotë se janë letargjikë dhe të pafuqishëm që të ngrihen në përgjithësi. Mendimi i tilli i prek mundësitë për çfarëdolloj ndryshimi. Çfarëdo që të mendojmë ne në atë drejtim, situatë është mjaft ndryshe, çështja kryesore është si të drejtohet vëmendja te një temë e caktuar, si të tërhiqen mediat, iniciativat dhe organizatat qytetare. Tashmë nuk bëhet fjalë për zgjim të ndonjë mase të fjetur – kjo me të vërtetë duket e pamundur – por për zgjerimin e fronit të luftës, veprimin e përbashkët, bashkëpunimin e të tjera. Është shumë indikative që organizata të shumta ekologjike, rinore dhe aktiviste të cilat janë krijuar në valët e reja të zhvillimit të shoqërisë qytetare në vitet nëntëdhjetë dhe dymijë në hapësirën e ish Jugosllavisë, nuk bashkëpunojnë me organizata të amatorëve, sindikatat, skautëve, alpinistëve e të tjera që janë themeluar para disa dekadave, kurse të cilët kanë ende anëtarë, përvojë të çmuar dhe disa resurse të cilat mund të bashkohen (kjo ndoshta në lidhje me mitin në vijim se këtu gjithçka ka mbetur pas dhe kështu ka qenë gjithmonë). Është e rëndësishme të hiqet diskursi për letargjinë e qytetarëve si ligj universal, të vihen re iniciativat dhe aktivitetet e ndryshme të qytetarëve dhe të hapet mundësia për një angazhim më të gjerë në çështjen e luftës për qytetin.

Ja, shiko, sa e mrekullueshme është bota!

Në rajonin tonë ekziston një mit i cili vlen të ndiqet nga afër. Shpesh në kërkim të praktikave të mira nga urbanizmi, mbrojtja, arkitektura, energjetika, ekologjia dhe fusha të tjera me rëndësi për zhvillimin shihet drejt Perëndimit. Ekziston një ndjenjë se gjithçka që është e mirë dhe si rrjedhim e qëndrueshme vjen nga Perëndimi. Nëse e dimë se edhe kështu nga i njëjti drejtim na vijë dhe teknologjitë, teoritë dhe “praktikat e mira” nga fusha të ndryshme, kjo nuk duhet të na habitë. Megjithatë, ajo që na habit është se ato shtete në të vërtetë i kanë shpikur teknologjitë më të këqija dhe mandej janë ndotësit më të mëdhenj globalë, kurse që është edhe më e rëndësishme, në ato shtete merren vendimet kryesore për të gjithë sistemin global të zhvillimit krejtësisht të paqëndrueshëm. Në këtë drejtim, duke ndjekur shumë

¹⁹Shkurtimi i njohur i Margaret Thaçer me të cilin i përshkruan bindjet dhe aktivitetet e veta politike: TINA që do të thotë “Nuk ekzistojnë alternativa” (There Is No Alternative), që në të vërtetë sugjeron se një mënyrë aktuale e mendimit dhe veprimit është e mundshme.

praktika nga Perëndimi, nuk do të arrijmë larg. Përveç kësaj, trashëgimia jugosllave është shumë interesante në aspektin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ndërtimi i atëhershëm i jetesës kolektive që sot shihet me indinjatë ishte në vijim me trendet më të reja botërore, kurse zgjidhjet ishin prodhim i mendimeve lokale.

Në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë janë organizuar dhjetëra kongrese intersektoriale të cilat janë marrë me temën e ekologjisë, shëndeti publik dhe ruajtjes së natyrë, kurse organizata të shumta, malësorë, të rinj, alpinistë e të tjerë konspironin ndryshime të marrëdhënies me natyrën. Në planin pesëvjeçar të vitit 1971 përmendet ruajtja e mjedisit jetësor. Kurse në vitin 1973 u formua Këshilli Jugosllav për Mbrojtjen dhe Përparimin e Mjedisit Njerëzor dhe fillon me revistën interdisciplinare profesionale dhe shkencore “Njeriu dhe mjedisi jetësor”: Me iniciativë të Këshillit në Kushtetutën e vitit 1974 u vendos e drejta çdo qytetari me mjedis të shëndetshëm që dekada më vonë është themel për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjës në deklaratat botërore me këtë temë. Domethënë, ekzistojnë shumë shkaqe në kërkim të zgjidhjes së mirë për zhvillimin e qëndrueshëm kryhet nisja pikërisht duke parë traditën e vet.²⁰

Prandaj është shumë e pazakonshme daljen në natyrë ta quajmë “viking” dhe ta lidhim me trendet e reja të ekoturizmit të Perëndimit nëse kemi njohuri për traditën e pasur të alpinistëve, malësorëve, skautëve; të konspirojmë praktika të reja “open-air classrooms” të cilat vijë nga bashkësitë “ekologjikisht të vetëdijshme”, nëse kemi njohuri se të gjitha shkollat në Jugosllavi sistematikisht i çonin fëmijët në shkollë dhe në natyrë; që për qasje pjesëmarrëse kah politikës dhe menaxhimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ndjekim shembujt e Britanisë së Madhe apo SHBA-së, nëse njohim shembuj për vetudhëheqje, bashkësi vedore, sindikata të organizuara mirë; dhe në fund për shembuj të aktivizmit dhe vullnetarizmit qytetar të shohim të njëjtën anë, ndërsa të lëmë anësh traditën e aksioneve të punës dhe format e tjera të angazhimit të popullatës sonë në ndërtimin e të mirave publike.

Nuk themi se politikat publike në Jugosllavi kanë qenë të përkryera dhe se janë zbatuar tërësisht, por ekzistonte korniza ligjore dhe shumë praktika të mira të cilat sot i kërkojmë në një vend tjetër.²¹ Gjithashtu ekzistimi i trashëgimisë lokale nuk do të thotë se duhet të mbyllemi në oborrin e vet, por takimi i ideve dhe qasjeve është i rëndësishëm për krijimin e ideve dhe qasjeve të reja. Megjithatë, vetëdija për faktin se politikat e ndryshme kanë qenë të mundshme në këtë fushë, është e rëndësishme sepse e rrëzon idenë e dëmshme se “prapambetja” e deritanishme është mundësia e vetme dhe se ndryshimi nuk është i mundshëm. Në vend të dekurajimit, thirrja në

²⁰Shiko më tepër në: Zoran Oštrić, Ekološki pokreti u Jugoslaviji, Građa za proučavanje razdoblja 1971-1991. U Sociološka ekologija (83-104), 1992.

[30] Shiko më tepër në: Jelena Ristić Trajković i Danica Stojiljković: Sustainability and socialism: socio-ecological ideas in the urbanization of New Belgrade. *Facta Universitatis, Series: Architecture and Civil Engineering*, (343-353), 2016.

²¹Është interesant shembulli për bregdetin i cili edhe tani është temë në Mal të Zi dhe Kroaci. Shumë funksionarë në vitet pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë i kanë ndërtuar vilat e para në plazhet e pazbuluara, por ka pasur kritika. Në një nga vizitat në Mal të Zi i ka qortuar pushtetet lokale: “I [must] unremittingly scold [you] because of the building of *vikendice* along the sea [...] It’s not right, because some fence in the sea, one can’t see the sea for all the houses. That’s how one destroys nature, ruins man’s natural environment.” “Titovi pogledi na turizam,” *Turizam* 28/5 (1980), p. 12. Više na temu vikendica: Karin Taylor My Own *Vikendica*: Holiday Cottages as Idyll and Investment (str. 171). In *Yugoslavia’s sunny side*, Central European University Press Budapest, 2010.

traditën lokale do ta nxiste opinionin më të gjerë dhe politikanët të sillen në mënyrë më përgjegjëse.

Të paktën të na ndodhë diçka e bukur.

Mitet të cilat i përmendëm më lart, të gjitha së bashku krijojnë një pamje shumë të pakëndshme mbi gjendjen aktuale dhe mundësitë për ndryshim të saj. Gjithçka është e tmerrshme, ata që na udhëheqin nuk e dinë ku, këtu nuk ndodh asgjë e mirë sepse jemi jashtë ndodhive botërore. Terreni është gati për dëshpërim të përgjithshëm. Në një kontekst të tillë aksionet , projektet dhe iniciativat triviale duken si një përpjekje e mirë që të paktën të bëhet diçka. Kjo është ajo që do ta quajmë politika – flaster. Në të vërtetë masat e nevojshme nuk miratohen. Në vend të tyre propagandohen slloganë ekologjikë, kompanitë i ndryshojnë logot e tyre në të gjelbër, paguhen qeset në market, vendosen ditë pa automobila, gjelbërohen çatitë e moleve për shopping... Të gjitha këto janë fllasterë në plagët e thella dhe thyerjet të cilat nuk e zgjidhin problemin, vetëm se krijojnë ndjenjë se prapë bëhet diçka. Njëkohësisht, proceset e refleksionit, analizës, debatit dhe ndryshimeve më serioze shtyhen për ndonjë të nesërme më të mirë.

Për qytete të qëndrueshme – rekomandime për mbartësit e vendimeve dhe aktorët e pavarur

Në pjesën përfundimtare të këtij teksti do të japim rekomandime për aktorët e ndryshëm (marrësit e vendimeve, organizatat dhe fushat e kulturës dhe artit, organizatat shkencore-arsimore dhe donatorët), ndërsa në bazë të përvojave të pilotuara gjatë projektit Act4City.

A. Përfaqësuesit e pushteteve/marrësit e vendimeve

Në kontekst të kuptimeve të lartpërmendura për qytet të qëndrueshëm dhe rolin e aktorëve të kulturës nga kjo fushë, projekti Act4City formuloi shtatë drejtime kryesore për marrësit e vendimeve të cilat menaxhojnë me zhvillim e qyteteve dhe me shpërndarjen e resurseve publike në to:

1. Pyetjet për zhvillimin e qyteteve janë komplekse dhe është e rëndësishme në kërkimin e përgjigjeve për to të marrin pjesë grupe të shumëllojshme dhe individë që të mbledhet diapazon më i gjerë i njohurive. Prandaj trupat e punës dhe komisionet duhet të jenë interdisciplinare, të hapura, dinamike dhe në fazat kryesore të mbledhin një spektër më të gjerë të vëzgimeve, me çka do të arrihen zgjidhjet më të mira.
2. Bashkëpunimi midis resorëve është i rëndësishëm në politikën e zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj është e rëndësishme pjesëmarrja e aktorëve nga fusha e kulturës dhe artit në një diapazon të gjerë të çështjeve me rëndësi për qytetin, siç janë: urbanizmi, arsimi, ekonomia, kurse gjithashtu, edhe për çështje nga kultura dhe arti të angazhuar në politikat e qytetit duhet të përfshihen edhe profesione të tjera – planifikues, inxhinierë për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ekonomistë, pedagogë, punonjës socialë e të tjerë.
3. Qyteti i qëndrueshëm është qytet ku aktorët e ndryshëm mund t'i shprehin nevojat, interesat dhe zgjidhjet e veta, prandaj është e rëndësishme të krijohet hapësirë për një rreth më të gjerë konsultimesh, takimesh dhe bisedimesh gjatë procesit të marrjes së vendimeve. Debatet publike nuk duhet të jenë hapi i fundit para miratimit të ndonjë zgjidhjeje, kurse projektet që miratohen dhe zbatohen me mjete publike duhet të jenë të arsyetuara dhe transparente.
4. Duhet të nxiten organizatat civile dhe institucionet nga fusha e kulturës dhe artit, por edhe më gjerë, që t'i ndjekin proceset e marrjes së vendimeve dhe të përfshihen në to kështu që programet, aktivitetet dhe intervenimet e veta do t'i kenë në drejtim të ndriçimit të çështjeve aktuale të cilat janë të rëndësishme për qytetarët dhe qytetaret.
5. Politikat kulturore të qyteteve dhe mekanizmat e financimit të organizatave dhe institucioneve nga fusha e kulturës duhet të nxitin krijim të përmbajtjeve kulturore dhe praktikave të cilat parashtrajnë çështje aktuale me rendis për qëndrueshmërinë urbane, ofrojnë përgjigje të mundshme dhe mënyra të ndryshme të pikëpamjeve mbi cilësinë e jetës, raportin me natyrën, pozitën shoqërore dhe politikat ekonomike.

6. Gjithashtu, politikat kulturore duhet t'i formulojnë mekanizmat e mbështetjes së organizatave nga fusha e kulturës dhe artit gjatë bashkëpunimit me sektorët e tjerë, si dhe t'i vlerësojnë veçanërisht eksperimentet që japin zgjidhje të reja për qytetin.
7. Është e nevojshme të ndërtohen vazhdimisht kapacitetet e institucioneve dhe aktorëve të pavarur në kulturë të cilët merren me çështjet për qytete të qëndrueshme dhe aktivizëm qytetar. Është e rëndësishme mekanizmat e financimit të mos i mbështesin vetë projektet e pjesshme afatshkurtra, por edhe programet afatgjata dhe hapësirat për takime.

B. Aktorët e pavarur në kulturë

Gjatë kërkimit të hapësirës për qytetarët/qytetaret aktive dhe aktorët e pavarur të cilët janë përfshirë në projektin Act4City u mbështet tek ideja se është e rëndësishme problematikën e menaxhimit me shoqërinë të mos e shqyrtojmë si çështje eksperte për mbrojtjen e llojeve të bimëve dhe kafshëve, prodhimin e energjisë dhe riciklimin, menaxhimin e normat e kamatave, planifikimin hapësinor, ndërtimtarinë dhe përparimin e ligjeve, por si çështje e jetës së përbashkët të njerëzve, makinerive, bimëve kafshëve dhe materies jo të gjallë në planet. Pikërisht në interpretimin e këtyre raporteve dhe çështjeve të organizatës në art dhe kulturë mund të japin kontribut të rëndësishëm në këto mënyra:

1. Në luftën për qytet të qëndrueshëm, aktorët e kulturës duhet të problematizojnë idenë e kulturës si të mirë të përgjithshme, të izoluar dhe të pazëvendësueshme dhe të këmbëngulin përmbajtjet kulturore të ofrojnë përgjigje për çështjet aktuale me rëndësi për publikun dhe ofrojnë një mënyrë tjetër të shikimit të realitetit, raporti i kulturës dhe natyrës, dhe cilësisë së jetës nga përmbajtjet kulturore globale apo tradicionale. Prandaj është e rëndësishme këta aktorë të ndjekin debatet publike dhe të ofrojnë hapësirë për alternativë, pjesëmarrje aktive të qytetarëve/qytetareve me profile të ndryshme dhe shprehje të mendimeve dhe pozitive të ndryshme.
2. Aktorët e pavarur në kulturë gjithnjë dhe më shpesh janë në linjën e parë të eksperimentit në fushën e formave të reja të politikës. Siç janë hapësirat për angazhim dhe politikë gjithnjë dhe më të ngushta, ashtu aktorët nga fusha e kulturës dhe artit duhet të shfrytëzojnë pozitën shoqërore për krijim të mikro hapësirave të politikës për qytetarët dhe qytetaret në procesin e produksionit të përmbajtjeve kulturore dhe intervenimeve hapësirën publike.
3. Lufta për qytet të qëndrueshëm duhet të jetë intersektoriale dhe nëpërmjet resurseve prandaj janë të domosdoshme hapësira për dialog dhe interpretim të përbashkët të alternativave për zhvillim të qyteteve me qytetarë/qytetare, politikanë, ekologë, ekonomistë dhe profesione të tjera. Kjo nuk do të thotë hedhje poshtë e ekspertizave specifike, por mbrojtje e interesit publik dhe hapësirës për debat publik prej mbylljes në rrethe të ngushta ekspertësh nga cilido specialitet.
4. Në debatet për qytet të qëndrueshëm aktorët në fushën e artit dhe kulturës duhet t'i zgjerojnë dispozitat gjeografike dhe kohore për kërkim të politikave

të qëndrueshmërisë jashtë shoqërive bashkëkohore perëndimore, dhe të hulumtojnë dhe të futin në hapësirën publike trashëgiminë nga periudha jugosllave si edhe politikat ekologjike, sociale dhe ekonomike të hapësirave jashtë evropiane i një inspirim i mundshëm.

5. Në konspirimin e politikeve publike transparente dhe përgjegjëse, organizatat e pavarura duhet të kontribuojnë edhe vetë mbi klimën në publik dhe transparencën, kështu që me burimet dhe mënyrat e veta të grumbullimit të mjeteve do të jenë më të hapur.

C. Donatorët

Donatorët e huaj janë faktor i rëndësishëm për nxitjen jo vetëm të projekteve të veçanta por edhe në mbajtjen e organizatave në punën e të cilave agjendat e tyre kanë ndikim të madh. Prandaj:


1. Donatorët e huaj duhet të jenë më të ndjeshëm ndaj specifikave të hapësirave nacionale dhe lokale, si edhe të mbështetin dhe përforcojnë iniciativat që tashmë ekzistojnë. Politikat e donatorëve do të duhet të formojnë pikë bashkëpunimi midis organizatave ekologjike të kohës së Jugosllavisë (shoqatat e alpinistëve, malësorëve, shërbimeve të pyjeve, lëvizjet rinore) dhe organizata e reja joqeveritare nga fusha e ekologjisë, zhvillimi urban dhe e kulturës.
2. Duke pasur parasysh se çështja për zhvillim e qëndrueshëm lidhet me politikat ekologjike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera, si dhe me qasjen integrale ndaj politikave publike, politikat e donatorëve dhe mekanizmat për mbështetje duhet të nxitin bashkëpunim ndërsektorial dhe midis resurseve, takime të ekspertizave të ndryshme, si dhe ekspertizë qytetare me iniciativë dhe zgjidhje për qytet të qëndrueshëm.
3. Politika e donatorëve dhe mekanizmat për mbështetje duhet të nxitin mejnstriming të zhvillimit të qëndrueshëm si prioritet në të gjitha fushat e planifikimit publik dhe zhvillimit të qyteteve: politikat ekonomike, sociale, urbanistike, ekologjike, arsimore, kulturore e të tjera.
4. Për interpretimin e iniciativave dhe arritjen të zgjidhjet specifike dhe ndryshimet në menaxhimin me qytetin drejt qytetit të qëndrueshëm, është e domosdoshme që politikat e donatorëve ta dallojnë rëndësinë e projekteve dhe iniciativave të cilat kanë komponentë eksperimentues dhe pionierë, dhe të cilat pilotojnë praktika dhe kontribute të cilat mund të jenë zgjidhje potenciale sistematike, dhe afatgjata.
5. Në nxitjen e aktorëve të cilët merren me qytetin e qëndrueshëm dhe angazhimin e qytetareve/qytetarëve, është e rëndësishme që donatorët përveç eksperimentit dhe financimit të projektit të njohin domosdoshmërinë për mbështetje të programeve afatgjata dhe hapësirave publike të cilat sigurojnë vazhdimësi në veprimtari për të mirën publike.
6. Në fund, që të rinovohen praktikat për menaxhim me qytetin, është e domosdoshme politikat donatore, përveç veprimeve dhe praktikave nxitëse, ta dallojnë dhe rëndësinë e detajeve dhe hulumtimeve gjithëpërfshirëse të

praktikave të deritanishme, me të cilat arrihet rekomandime për veprim të ardhshëm dhe politika të bazuara në fakte.

D. Institucionet dhe organizatat arsimore-shkencore

Si organizata të drejtuara kah krijimit të njohurive, mënyrave të reja dhe ekzistuese, edhe institucionet arsimore, luajnë rol të rëndësishëm jo vetëm në krijimin e ekspertëve përgjegjës dhe të vetëdijshëm, por edhe në formësimin e debateve publike për tema të caktuara. Prandaj është e rëndësishme këto institucione të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e qyteteve në këtë mënyra:

1. Në programet arsimore aspektet interdisiplinore të çështjeve të zhvillimit të qytetit duhet të jenë më të pranishme. Pa marrë parasysh se këto institucione nxjerrin arkitektë, urbanistë, ekologë, sociologë, artistë, gazetarë apo ekonomistë, është e rëndësishme të gjitha profesionet të dallojnë kontributet kryesore të profesionit të tyre për çështje të qëndrueshmërisë si dhe aspektet kryesore të profesioneve të tjera për të njëjtat çështje. Prandaj propozohen seminare, punëtori kampe verore dhe dimërore dhe përmbajtje të tjera kurikulare dhe ekstrakurikulare ndërdisiplinore që u dedikohen çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit.
2. Në hulumtimet me temë zhvillim i qëndrueshëm, me rëndësi të jashtëzakonshme në kërkimin e zgjidhjes, të mos harrohen çështjet për shkaqet e problemeve, historia e zhvillimit të ideve dhe marrëdhëniet shoqërore dhe politike të cilat janë pas disa ideve, kështu që zgjidhja nuk do të jetë kozmetike dhe nuk do të kontribuonin në mbajtjen e *status quo*-s.
3. Trashëgimia dhe përvoja jugosllave dhe botërore (joevropiane) nga fusha e zhvillimit të qëndrueshëm duhet të marrë një vend më të theksuar në hulumtimet dhe programet arsimore, sepse është një përvojë jashtëzakonisht e çmuar në kërkimin e zgjidhjes për zhvillim të qëndrueshëm, si edhe të pasojave negative të disa zgjidhjeve të zbatuara të cilat janë më pak të dukshme në shtetet më të zhvilluara.



ACT4CITY - Independent cultural actors towards sustainable Balkan cities е проект кој промовира пристап на одржливост на градовите преку заеднички едукативни, уметнички и активности на јавно застапување. Проектот го реализираат Експедицио, Котор, МЕ; Министерство за простор, Белград, РС; Градска Креативна Мрежа, Скопје, МК; Уметничка работилница Лазарети, Дубровник, ХР. The project ACT4CITY is funded by **Balkan Arts and Culture Fund BAC**. BAC is supported by the Swiss Government through the **Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC)** and the **European Cultural Foundation (ECF)**.